



Skema e granteve bashkefinancohet nga BE dhe Qeveria Shqiptare, zbatohet nga GIZ dhe AZHBR

Njoftim

Hapja e Thirrjes së 3^{të} për dorëzimin e Aplikimeve:

Skema e Granteve “IPARD-like” për zhvillimin e sektorit agro-ushqimor në Shqipëri,

2012 - 2014

Për vëmendjen e publikut të gjerë

Autoriteti Kontraktues informon se **Thirrja e 3^{të} për dorëzimin e Aplikimeve** në kuadër të Skemës së Granteve “IPARD-like” të Projektit EU-IPA 2011 “Mbështetje për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural” (SARD) do të hapet nga data **17 Mars 2014** deri në datën **02 Maj 2014**.

Buxheti i përgjithshëm i skemës së granteve IPARD-like: 8.2 mil. EURO, nga të cilat 6.2 mil. EURO janë kontribut i BE-së dhe 2.07 mil. EURO kontribut i Qeverisë Shqiptare.

Zbatimi i skemës së granteve: GIZ dhe Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR).

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është data 02 Maj 2014, ora 16:30 (sipas orës lokale).

Aplikimet dorëzohen në zyrat e AZHBR-së ish-ndërtesën e zyrave qendrore të AKU-së Rr. ‘Muhamet Gjollështa’, nr.56, 1000, Tiranë!

Vini re: Të gjithë Aplikantët potencialë janë të lutur ti referohen vetëm Udhëzuesit të ri për Aplikantët (versioni 3.0).

Udhëzuesi i ri për Aplikantët version 3.0, anekset përkatëse të tij si dhe të gjitha informacionet e tjera të nevojshme mund të gjenden në faqet e internetit www.IPARD-like.al dhe www.azhbr.gov.al.

Kopje të printuara falas të Udhëzuesit të ri për Aplikantët mund të gjenden në zyrat qendrore të AZHBR-së Rr. ‘Muhamet Gjollështa’ nr.56, 1000 Tiranë, në Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë (DRB) dhe në zyrat e Projektit GIZ SARD-IPARD në amjentet e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU)

Ju lutem përdorni vetëm modelet e Formularit të Aplikimit dhe të Planit të Biznesit të Udhëzuesit të Ri për Aplikantët (versioni 3.0) të cilët mund të shkarkohen nga faqet e internetit www.IPARD-like.al dhe www.azhbr.gov.al. Formulari i Aplikimit dhe plani I biznesit (pjesa përshkruese dhe ajo e pasqyrave financiare) detyrimisht duhet që të plotësohen elektronikisht dhe





pastaj të printohen. Aplikantët detyrohen që të mbajnë një kopje të të gjithë dokumenteve të dorëzuara me formularin e aplikimit.

Datat dhe vendet e sesioneve informuese dhe të trajnimit në qarqe për të gjithë të interesuarit, aplikantë, konsuletë publikë apo privatë apo palë të tjera të interesuara do të njoftohen nëpërmjet faqeve të internetit www.IPARD-like.al dhe www.azhbr.gov.al.



giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

